

RAPORTI I BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE 2025

GJILAN

Përmbajtja

Hyrje	3
Kriteret për përzgjedhjen e lokaliteteve	3
Kriteret për financimin e projekteve	3
Përgatitjet dhe organizimi i konsultimeve publike	3
Takimet e para	4
Faza e dytë	6
Takimet e dyta	6
Sfidat dhe Rekomandimet e Procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje	9

Hyrje

Buxhetimi me Pjesëmarrje si formë e re e planifikimit dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrjen lokale është organizuar në Komunën e Gjilanit gjatë muajit maj me katër lagje të qytetit: lagjja “Zabeli”, “Tregu i Gjelbër”, “Rruga e Prishtinës”, “Lagjja e Tetë”; tri fshatra: Pogradja, Livoçi i Epërm, Gumnishta dhe grupin e grave.

Lagjet që janë përfshirë në këtë formë buxhetimi ishin më pak të përfshira në investime në vitet e fundit, ndërsa grupi i grave ka marrë pjesë edhe kësaj radhe, për të dytën herë sepse ky vit është shpallur në Republikën e Kosovës, Vit i Gruas.

Kriteret për përzgjedhjen e lokaliteteve:

Përmes kriterëve kemi synuar gjithëpërfshirjen dhe barazinë:

1. Lagjet dhe fshatrat me më pak investime në 5 vitet e fundit dhe me më shumë nevoja për investime
2. Numri i madh i banorëve përfitues
3. Komunitetit i grave
4. Një lokalitet me më pak banorë dhe në distancë më të largët nga qendra
5. Komunitetet me mungesë të infrastrukturës bazë

Kriteret për financimin e projekteve:

- Lloji i projekteve: Investime Kapitale
- Projekt-propozimi të jetë brenda kornizave të buxhetit të prezantuar nga komuna
- Numri i përfituesve nga projekti i propozuar të jetë sa më i madh, sidomos në rastet e barazimit të votave
- Projekti të ketë ndikim social, ekonomik dhe mjedisor
- Projekti të jetë gjithëpërfshirës duke përfshirë grupe të marginalizuara, veçanërisht gratë dhe të rinjtë
- Lokacioni i projektit të propozuar të jetë në pronësi të komunës ku disponueshmëria konfirmohet zyrtarisht nga komuna
- Vlera e projektit- 50 mijë euro.

Përgatitjet dhe organizimi i konsultimeve publike

Përgatitjet kanë filluar me takimin e parë të Grupit Punues për konsultime publike për të vazhduar më pas me takimin e Grupit Punues me përfaqësues të këshillave të fshatrave, shoqërisë civile, komuniteteve jo-shumicë dhe drejtorë të shkollave të lokaliteteve pjesëmarrëse.

Procesit të buxhetimit i ka paraprirë fushata informuese. Njoftimet për konsultime publike janë publikuar në rrjete sociale, portale lokale dhe postera njoftues të vendosur në institucione publike, në drejtori të Administratës, pranë Kuvendit Komunal, në zyrat e gjendjes civile në lokalitetet e përfshira, ambulanta dhe qendra të mjekësisë familjare, shkolla fillore dhe kampusin e shkollave të mesme, dhe në Universitetin Publik të Gjilanit “ Kadri Zeka”.

Orari i takimeve:

Takimet e para

1. Takimi në Lagjen “Zabeli” -14 maj

- Pjesëmarrës:28
- Projektet e prioritizura:
 - *Rregullimi i hapësirës rekreative*
 - *Kënd i lodrave për fëmijë*
 - *Rregullimi i shtratit të lumit*
 - *Vendosja e shportave për mbeturina*
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit: 26 maj

2. Takimi në Lagjen “Rruga e Prishtinës” -15 maj

- Pjesëmarrës:16
- Projektet e prioritizura:
 - *Parkingu rreth shkollës*
 - *Parku i lodrave për fëmijë*
 - *Fusha e basketbollit*
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit: 26 maj

3. Takim në Lagjen e Tetë- 16 maj

- Pjesëmarrës:15
- Projektet e prioritizura:
 - *Terren sportiv*
 - *Parku i lagjes*
 - *Rregullimi i rrugës afër shkollës*
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit:27 maj

4. Takim në Lagjen “ Tregu i Gjelbër”- 17 maj

- Pjesëmarrës:10
- Projektet e prioritizura:
 - *Drunj dekorativ*
 - *Shporta për mbeturina*
 - *Këndi i lodrave për fëmijë*
- Buxheti: 50,000.00 euro

- Data e votimit:27 maj

5. Takimi në Livoç të Epërm -20 maj

- Pjesëmarrës:12
- Projektet e prioritizura:
 - *Rregullimi i terrenit sportiv*
 - *Parku në lagjen e muhaxhirëve*
 - *Parku në lagjen e re*
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit:28 maj

6. Takimi në Pogragjë -21 maj


- Pjesëmarrës:18
- Projektet e prioritizura:
 - *Rinovimi i urës*
 - *Mbrojtëse anësore në Rrugën për Uglar*
 - *Shtigje për ecje*
 - *Zgjerim i hapësirave publike për rekreacion*
 - *Pajisje të fitnesit në hapësira të parqeve*
 - *Asfaltimi i rrugëve*
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit:29 maj

7. Takim në Gumnishtë -22 maj

- Pjesëmarrës:18
- Projektet e prioritizura:
 - *Rregullimi i shtratit të lumit*
 - *Kabina të pritjes për udhëtar*
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit:30 maj

8. Takim me gra dhe vajza – 23 maj

- Pjesëmarrës:10
- Projektet e prioritizura:
 - *Tualet dhe çezme publike*
 - *Këndi i kurajës-punime artizanale*
 - *Pjerrina për persona me nevoja të veçanta*
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit 30 maj



Paraqitja tabelare e pjesëmarrësve:

Vendi/grupi	Data	Pjesëmarrës	Burra	Gra
Lagjja "Zabeli"	14 maj	28	28	
Lagjja "Ruga e Prishtinës"	15 maj	16	14	2
Lagjja e Tetë	16 maj	15	14	1
Lagjja "Tregu i Gjelbër"	19 maj	10	6	4
Livoç i Epërm	20 maj	12	12	
Pogragjë	21 maj	18	18	
Gumnishtë	22 maj	18	18	
Gratë	23 maj	10		10
Totali		127	110	17



Gjatë konsultimeve publike qytetarët pjesëmarrës patën mundësinë të ndajnë dhe trajtojnë me zyrtarët komunal shumë çështje dhe kërkesa të komunitetit, pos propozimeve që dhanë në harmoni me kriteret e vendosura për buxhetimin me pjesëmarrje.

Fondet për këtë format të planifikimit për vitin 2025 ishin 400 mijë euro.

Faza e dytë

Përgatitjet kanë filluar me takimin e Grupit Punues, për të vazhduar me publikimin e njoftimeve, inkurajimin e qytetarëve për pjesëmarrje dhe procesin e votimit të propozimeve të marrura në fazën e parë të konsultimeve publike.

Takimet e dyta

1. Takimi në Lagjen “Zabeli”

- Pjesëmarrës:27
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
 - ***Rregullimi i hapësirës rekreative***
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit:26 maj

2. Takimi në Lagjen “Rruga e Prishtinës”

- Pjesëmarrës:17
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
 - ***Parkingu rreth shkollës***
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit:26 maj

3. Takim në Lagjen e Tetë

- Pjesëmarrës:31
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
 - ***Parku i lagjes***
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit:27 maj

4. Takim në Lagjen “Tregu i Gjellbër”

- Pjesëmarrës:6
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
 - ***Këndi i lodrave për fëmijë***
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit:27 maj

5. Takimi në Livoç të Epërm

- Pjesëmarrës:11
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
 - ***Parku në lagjen e muhaxhirëve***
- Buxheti: 50,000.00 euro

- Data e votimit: 28 maj

6. Takimi në Pogragjë

- Pjesëmarrës: 15
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
 - **Zgjerim i hapësirave publike për rekreacion**
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit: 29 maj

7. Takim në Gumnishtë

- Pjesëmarrës: 10
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
 - **Rregullimi i shtratit të lumit**
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit: 30 maj

8. Takim me gra dhe vajza

- Pjesëmarrës: 21
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
 - **Pjerrina për persona me nevoja të veçanta**
- Buxheti: 50,000.00 euro
- Data e votimit: 30 maj



Paraqitja tabelare e pjesëmarrësve:

Vendi/grupi	Data	Pjesëmarrës	Burra	Gra
Lagjja “Zabeli”	26 maj	27	27	
Lagjja” Rruga e Prishtinës”	26 maj	17	15	2
Lagjja e Tetë	27 maj	31	25	6
Lagjja “Tregu i Gjellbër”	27 maj	6	6	
Livoç i Epërm	28 maj	11	11	
Pogragjë	29 maj	15	14	1
Gratë	30 maj	21		21
Gumnishtë	30 maj	10	10	
Totali		138	108	30



Sfidat dhe Rekomandimet e Procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje

Buxhetimi me pjesëmarrje siguron përfshirjen e qytetarëve në planifikim të investimeve në raport me nevojat dhe kërkesat e komunitetit duke mundësuar ndarje të drejtë të fondeve publike dhe vendosjen e qytetarit në qendër të procesit, në rolin vendimmarrës. Dialogu social, avancimi i relacionit qytetar-zyrtar dhe ngritja e besueshmërisë ndaj institucioneve janë rezultatet e bashkëpunimit në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje.

- Pjesëmarrja e Grave në konsultime publike mbetet relativisht e vogël dhe sfidë edhe këtë vit, përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për të inkurajuar gratë që të marrin pjesë në buxhetim.

Rekomandim- përgatitja e strategjisë apo një plani konkret që adreson dhe trajton çështjen e diferencës gjinore në pjesëmarrje dhe planifikim.